

U D H Ë Z I M
Nr. 5, datë 13.4.1993

PËR KUSHTET THEMELORE TË KONTRATËS KOLEKTIVE TË PUNËS

Në zbatim të ligjit nr.7673, datë 17.2.1993 "Për kontratat kolektive të punës", me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

Në kontratën kolektive të punës duhet të përcaktohen:

1. Palët kontraktuese

a) Në nivel ndërmarrjeje kontrata kolektive lidhet nga punëdhënësi ose përfaqësuesi i tij dhe nga komisioni përfaqësues i punëmarrësve në këtë nivel, që zgjidhet sipas nenit 6 të ligjit "Për kontratat kolektive të punës".

Për krijimin e komisionit përfaqësues të punëmarrësve çdo sindikatë duhet të paraqesë deklaratat personale të anëtarëve të saj.

b) Për lidhjen e kontratës kolektive në nivel dege përfaqësues të punëdhënësve janë organet drejtuese të bashkësive ekonomike, korporatave, shoqatave të punëdhënësve dhe për sektorin buxhetor ministritë përkatëse. Për këtë qëllim punëdhënësit mund të krijojnë një ose disa shoqata, anëtarë të cilave mund të jenë punëdhënës të sektorit shtetëror ose privat. Nëse krijohet një shoqatë, punëdhënësit brenda kësaj shoqate mund të krijojnë seksione në bazë dege, që hyjnë në bisedime për të përfunduar kontratën kolektive në degën përkatëse. Në sektorin buxhetor përfaqësuesi i punëdhënësit është ministri përkatës, ose një person i autorizur prej tij. Përfaqësuesi i punëmarrësve në këtë nivel përcaktohet në nenin 7 të ligjit "Për kontratat kolektive të punës".

c) Në degët jobuxhetore, që nuk janë të organizuara në bashkësi ekonomike, korporata ose shoqata, lidhja e kontratës kolektive do të bëhet sipas shkronjes "a" të kësaj pike.

2. Përmbajtja e kontratës

a) Fusha e zbatimit të kontratës përcakton sektorin e veprimtarisë ku shtrin efektet kjo kontratë.

b) Kohëzgjatja e kontratës kolektive.

Kontrata kolektive lidhet për një kohë të caktuar deri në 1 vit, ose për një kohë të pacaktuar. Palët mund të hyjnë në bisedime për përfundimin e një kontrate të re 60 ditë para përfundimit të afatit të kontratës ekzistuese.

c) Pranimi në punë dhe largimi nga puna.

Në kontratën kolektive palët në marrëveshje mund të parashikojnë, përveç kriterëve të përgjithshme ligjore të marrjes në punë, edhe kushtet e posaçme që kanë lidhje me veçoritë e vendit të punës, moshën, gjininë, profesionin, gjendjen shëndetësore, kualifikimin etj. Palët mund të parashikojnë edhe përparësinë për pranimin në punë të punonjësve që kanë dalë në asistencë, kur ata plotësojnë kriteret e mësipërme.

Në kontratën kolektive në marrëveshje ndërmjet tyre mund të parashikojnë, përveç kriterëve të përgjithshme ligjore të largimit nga puna, edhe kriteret e posaçme që kanë lidhje me veçoritë e vendit të punës.

ç) Koha e punës.

Palët kontraktuese përcaktojnë kohën normale të punës në bazë të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi. Në sektorin privat koha normale e punës nuk mund të jetë më e gjatë se koha normale e punës e përcaktuar për sektorin analog shtetëror. Palët përcaktojnë orën e fillimit dhe

mbarimit të kohës normale të punës ose të ndërresave, pushimin gjatë kohës së punës, mundësinë e mënjanim të punës së grave, të të rriturve dhe punonjësve me aftësi të kufizuar në ndërresat e natës.

Palët kontraktuese, duke u mbështetur në dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, përcaktojnë sasinë e orëve jashtë kohës normale të punës dhe shpërblimin përkatës. Në sektorin privat sasia maksimale e orëve jashtë kohës normale të punës nuk mund të jetë më shumë se sasia e përcaktuar me ligj. Gjithashtu, pagesa për këtë sasi orësh nuk mund të jetë më e vogël se ajo e përcaktuar me ligj.

d) Koha e pushimit.

Në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi dhe sipas veçorive të sektorëve, palët përcaktojnë:

- ditët e pushimit javor, vjetor dhe të festave zyrtare;
- planin e lejes vjetore të pagueshme;
- dhënien e lejes së jashtëzakonshme në rast fatkeqësie dhe gëzimesh familjare;
- dhënien e lejes së pagueshme anëtarëve të sindikatës për pjesëmarrjen e tyre në veprimtaritë lokale, kombëtare ose ndërkombëtare.

dh) Paga.

Palët kontraktuese në sektorin shtetëror buxhetor përcaktojnë pagat në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Në sektorin shtetëror jobuxhetor dhe pjesërisht jobuxhetor palët kontraktuese përcaktojnë pagat mujore.

Palët kontraktuese në sektorin privat përcaktojnë pagat mujore, që nuk duhet të jenë më të vogla se paga minimale e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Njëkohësisht ato mund të parashikojnë në kontratë mundësinë e rritjes dhe indeksimit të pagave në përputhje me ndryshimin e faktorëve që ndikojnë në nivelin e jetesës.

Kontrata kolektive duhet të përmbajë edhe mënyrën e dhënies së pagës, të shtesave mbi pagë e shpërblimeve, si dhe pagesën në rast transferimi të përkohshëm a të përhershëm, pagesën për punën e kryer jashtë kohës normale të punës, në ditët e pushimit javor e të festave zyrtare a fetare dhe në ndërresat e natës.

Palët kontraktuese përcaktojnë edhe masën e pagesës të punonjësve në rastet kur puna ndërpritet jo për faj të tyre.

e) Sigurimet shoqërore.

Në kontratën kolektive të punës duhet të parashikohet derdhja e kontributit të sigurimeve shoqërore për paaftësinë në punë, për shkak sëmundjeje, barrë lindjeje, pleqërie, invaliditeti, humbje të mbajtësit të familjes, aksidenti në punë, sëmundjeje profesionale, si dhe për papunësinë, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

ë) Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës.

Palët kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e punës në fuqi, merren vesh për:

-sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të punës, mbrojtjen në punë, sigurimin teknik, kushte higjieniko-shëndetësore, transportin e punonjësve në qendrën e punës etj.;

-realizimin e fondeve të investimeve për objektet sociale të trajtimit të punëmarrësve;
-ngritjen tekniko-profesionale dhe organizimin e veprimtarive çlodhëse për punëmarrësit;
-mundësinë e përballimit të shpenzimeve për ushqim dhe trajtim mjekësor të punëmarrësve;

- mundësinë e sistemimit në punë të përshtatshme të grave shtatzëna dhe të të miturve;

- sistemimin me përparësi në punë të përshtatshme të invalidëve.

f) Liritë sindikale.

Në kontratën kolektive duhet të parashikohet detyrimi i punëdhënësit për t'i krijuar kushtet dhe lehtësitë e duhura sindikalistëve për plotësimin e të drejtave dhe detyrave sindikale që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

g) Sanksionet.

Palët, në marrëveshje ndërmjet tyre, parashikojnë llojin dhe masën e kushtit disiplinor që ato duhet t'i paguajnë njëra-tjetrës, nëse nuk përmbushen në mënyrë të plotë a të pjesshme detyrimet që burojnë nga kontrata kolektive.

Kushti disiplinor mund të jetë në formën e një shume fikse, ose në formën e disa pagave mujore.

Punëdhënësi, në marrëveshje me punëmarrësit, mund të përcaktojë në kontratën kolektive masat disiplinore që do të merren në rastet e thyerjes së disiplinës në punë, si dhe procedurën e marrjes së tyre.

gj) Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në punë.

Në kontratën kolektive palët mund të parashikojnë mundësinë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në punë nëpërmjet bisedimeve ndërmjet përfaqësuesve të punëdhënësve dhe punëmarrësve, përpara se çështja t'u kalojë organeve kompetente shtetërore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të ligjit nr.7673, datë 17.2.1993 "Për kontratat kolektive të punës".

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi